



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 5005 / Prot.

Tiranë, më 9 / 11 / 2020

URDHËR

Nr. 615, datë 9 . 11 . 2020

“PËR

**KUFIZIMIN E AKTIVITETEVE TË BAREVE, RESTORANTEVE, FAST FOOD  
DHE LOKALEVE”**

Në zbatim të nenit 7, pika 4 gërma b të ligjit Nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik si dhe në zbatim të Vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr.prot. 5005, datë 09.11.2020, me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

**URDHËROJ:**

1. Kufizimin e aktivitetit të bareve, restoranteve, fast food, lokaleve që ofrojnë shërbim për klientët, nga ora 22:00 deri në orën 06:00, në të gjithë vendin, deri në datën 02.12.2020.
2. Përjashtim nga rregulli i përcaktuar në pikën 1, bëhet vetëm për shërbimin në banesë (delivery), i cili duhet të kryhet duke respektuar rregullat higjienike të miratuara.
1. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri organet kompetente për dhënien e masave administrative sipas Aktit Normativ nr. 3 datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së shkaktuar nga Covid19”, i ndryshuar.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe fillon efektet më datë 11.11.2020.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu



